 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

1. QËLLIMI I PROJEKTIT

ISO 27001 është standardi i vetëm që përcakton specifikimet për një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS).

Gjithnjë e më shumë institucione dhe kompani po arrijnë certifikimin ISO 27001 për të nënvizuar qëndrueshmërinë e menaxhimit të tyre të sigurisë së informacionit. Organizatat të cilat janë të certifikuara me ISO 27001 kanë një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit që siguron konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave dhe informacionit që ata trajtojnë. Politikat, proceset dhe procedurat që përbëjnë këtë sistem menaxhimi shqyrtohen dhe testohen çdo vit nga auditorë të pavarur të palëve të treta, të cilët kanë fuqinë të tërheqin certifikimin nëse gjërat nuk janë në rregull.

Organizatat gjithnjë e më shumë duhet të tregojnë se mund të besohen për sigurinë e informacionit dhe menaxhimin e privatësisë dhe të kesh ISO 27001 tregon se një organizatë ka identifikuar rreziqe dhe ka vendosur masa parandaluese për të mbrojtur organizatën nga shkeljet e sigurisë së informacionit

2. OBJEKTI I PROJEKTIT

Zbatimi i një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit do të sigurojë Albpetrol sh.a një sistem që do të ndihmojë në eliminimin ose minimizimin e rrezikut të një shkelje të sigurisë që mund të ketë implikime ligjore ose të vazhdueshmërisë së biznesit.

Një sistem efektiv i menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001 (ISMS) siguron një kuadër menaxhimi të politikave dhe procedurave që do të mbajnë informacioni të sigurt, pavarësisht nga formati. Pas një sërë rastesh të profilit të lartë, është vërtetuar se është shumë e dëmshme për një organizatë nëse informacioni bie në duar të gabuara ose në domain publik. Duke krijuar dhe mbajtur një sistem të dokumentuar të kontrolleve dhe menaxhimit, rreziqet mund të identifikohen dhe zvogëlohen.

Implementimi i ISO 27001 tregon se Albpetrol ka:

- Informacion të mbrojtur nga marrja e personave të pa autorizuar;
- Informacioni i siguruar është i saktë dhe mund të modifikohet vetëm nga përdoruesit e autorizuar;
- Vlerësuar rreziqet dhe zbutur ndikimin e një shkelje;
- Është vlerësuar në mënyrë të pavarur sipas një standardi ndërkombëtar bazuar në praktikën më të mirë të industrisë.

Albpetrol sh.a operon në Patos, Ballsh – Cakran – Molja, Vllahinë – Kocul dhe Kucove si dhe një Seli Qendrore në Rr. “Fier – Patos”, km.7.

Të gjitha këto vende të ushtrimit të aktivitetit të Albpetrol sh.a, do të jenë objekt auditimi dhe vizite gjatë procesit të certifikimit. Siguria korrekte e aktiviteteve institucionale lidhur me proceset korporative nga Albpetrol sh.a janë të lidhura me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave në sistemet informatike.

Në këtë kontekst, duke marrë parasysh atë që është parashikuar nga Planet Vjetore për Informatikën në Administratën Publike dhe AKCESK (AKSK), Albpetrol sh.a ka vendosur të përcaktojë dhe të zbatojë një Sistem Efikas të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (në vijim "ISMS"), sipas versionit EN ISO 27001:2022.

3. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR CERTIFIKIMI I SIGURISE ISO 27001:2022 DHE IMPLEMENTIMI I TIJ NE ALBPETROL SH.A

1. Infrastruktura IT

Infrastruktura siguron rrugën e komunikimit dhe shërbimet ndërmjet përdoruesve, proceseve, aplikacioneve, shërbimeve, rrjeteve të brendshme dhe të jashtme / internetit. Albpetrol sh.a ka rreth 260 kompjutera dhe përdorues të lidhur në rrjet, përfshirë Administratën Qendrore, 3 Qendra Prodhimi të Naftës dhe 7 Qendra Shërbimi. Sistemi operativ i instaluar në PC janë Windows.

Dhoma e serverit është qendra kryesore e rrjetit tonë dhe është një vend në të cilin janë vendosur të gjitha serverat dhe sistemet operacionale (Firewall, Switch aksesit dhe SAN, Servera backup, etj.) Të gjithë serverët do të ndajnë një Hapesire të Ruajtjes së të dhënave(SAN) që përbëhet nga storage.

Për rritjen e burimeve të infrastrukturës përdoret teknologjia e virtualizimit e cila konsiston në përmirësimin e serverëve, shfrytëzimin dhe konsolidimin, alokimin dinamik të burimeve dhe menaxhimin, izolimin e ngarkesës së punës, sigurinë dhe automatizimin. Virtualizimi bazohet në hypervisor VMWARE dhe HYPER-V. Hosts janë konfiguruar në grup me disponueshmëri të lartë e cila përdoret për të përmirësuar besueshmërinë, duke ulur kohëzgjatjen në mjedise virtuale dhe për të përmirësuar rikuperimin në rastin e fatkeqësive natyrore.

Sistemi operativ që përdoret për platformat e serverit janë Windows Server, Linux, VMware dhe CentOS.

Infrastruktura ka këto shërbime:

- Redundant Domain Controller;
- Arkiva digjitale;
- Azure AD;
- Forcepoint;
- Sistemi i menaxhimit të alarmeve në dhomën e serverave;
- Akses kontrolli për dhomën e serverave;
- Sistemi GPS;
- Sistemi ERP;
- Wireless Controller, VPN, Clearpass;
- XVR, NVR;
- Etj.

Sisteme të cilat janë në Cloud:

- Office 365 dhe email adresat;
- Eëbsite ëëë.albpetrol.al

Infrastruktura ka dy linja mbështetëse të ofruesve të internetit. Linja primare ofrohet me fibër optike dhe linja dytësore ofrohet me Radio Link.

Infrastruktura ofron shërbime interneti të dedikuara për:

- Përdoruesit e Administratës Qëndrore;
- Përdoruesit e Qëndrave të Shërbimit dhe Prodhimit;
- Platforma e Operimit të Sistemit;
- Rrjetin Wireless;
- Etj.

Janë disa rregulla të përcaktuara se cilat lloje të trafikut të rrjetit do të lejohen përmes fireëall dhe çfarë do të bllokohet nga shërbime të ndryshme.

Infrastruktura e rrjetit dhe komunikimi ndërmjet qëndrave realizohet nga linjat VPN.

Aplikacioni për filtrim në internet parandalon aksesin në materiale të dëmshme ose të papërshtatshme, gjithashtu monitorimi na ndihmon për të identifikuar aktivitetin online në internet për të gjithë përdoruesit.

2. Nisur nga rëndësia e sistemeve të teknologjise së sistemeve IT/OT nevojitet Përgatitja për Certifikim ISO 27001 për sigurinë e informacionit në Albpetrol sh.a , sipas versionit të standardit ISO 27001:2022.

3. Adoptimi dhe zhvillimi i një sistemi menaxhimi sipas standardeve ISO, është një vendim strategjik që i mundëson Albpetrol sh.a përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së përgjithshme.

4. Standardi ISO që duhet implementuar në Albpetrol sh.a.

Duke u bazuar edhe tek kërkesat e institucioneve si AKCESK (AKSK) por edhe praktikën më të mirë Ndërkombëtare, në Albpetrol sh.a kërkohet:

- ISO 27001:2022 – Sistemi Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit

5. Kërkesat e Implementimit dhe Certifikimit të Albpetrol sh.a.

Dy janë fazat nëpër të cilat duhet të kalojë ky proces:

1. Konsulenca, Hartimi, Implementimi dhe Trajnimi

Fillimisht, procesi duhet të udhëhiqet dhe të implementohet nga një kompani e specializuar në konsulencë për ndërtimin, përshtatjen, realizimin, implementimin dhe trajnimin e stafit për të përmbushur kërkesat e azhuruara të standardeve ISO/IEC 27001:2022. Kjo kërkesë për një studio të specializuar në konsulencë është kritike, pasi kërkon një konsulencë të integruar që përmban ekspertizën teknike mbi normat dhe azhurnimet e tyre, si dhe mbi aktivitetin specifik që ofron Albpetrol sh.a.

Gjithashtu, është e rëndësishme që studioja e konsulencave të ketë njohuri të thella në lidhje me udhëzimet e standardeve për sigurinë e informacionit, siç janë ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019. Përmes trajnimeve dhe implementimeve të kujdesshme, personeli i Albpetrol sh.a do të pajiset me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të menaxhuar sigurinë e informacionit në përputhje me kërkesat e këtyre standardeve të rëndësishme.

Për hartimin e politikave dhe procedurave sipas standardit ISO 27001:2022, Albpetrol sh.a do të duhet të ndjekë një proces të strukturuar dhe të kujdesshëm që i përmbush kërkesat e këtij standardi të rëndësishëm për sigurinë e informacionit. Kjo përfshin një sërë hapash që organizata duhet të ndërmarrë për të përshtatur politikat dhe procedurat e saj ekzistuese ose për të hartuar të reja që përputhen me kriteret e ISO 27001:2022. Këto hapa përfshijnë:

- Identifikimi i Politikave Ekzistuese dhe Mungesave: Fillimisht, Albpetrol sh.a do të duhet të identifikojë politikat dhe procedurat ekzistuese për sigurinë e informacionit në organizatë. Ky proces do të përfshijë një analizë të hollësishme për të vlerësuar se ku ndodhen politikat aktuale, cilat janë përmirësimet e nevojshme dhe cilat mungojnë në përputhje me standardet e ISO 27001:2022.
- Hartimi i Politikave të Reja: Bazuar në identifikimin e mungesave dhe nevojat e organizatës për të përmbushur kërkesat e ISO 27001:2022, Albpetrol sh.a do të hartojë politika të reja për sigurinë e informacionit. Këto politika do të përfshijnë një gamë të gjerë të çështjeve si menaxhimi i rrezikut, qasja në informacion, siguria fizike dhe logjistika, siguria e rrjetit, dhe të drejtat e përdoruesve. Politikat e reja duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të përshtatshme për nevojat specifike të organizatës.
- Hartimi i Procedurave të Reja: Për të përkrahur politikat e reja të sigurisë së informacionit, Albpetrol sh.a do të duhet të hartojë procedura të detajuara që t'i përmbushin kërkesat specifike të këtyre politikave. Këto procedura do të përshkruajnë hapat e nevojshëm për të zbatuar politikat në praktikë, duke përfshirë proceset për identifikimin e rreziqeve, vlerësimin e tyre, dhe marrjen e masave për zbutjen e tyre.
- Kontrolli dhe Mirëmbajtja e Politikave dhe Procedurave: Pas hartimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave të reja të sigurisë së informacionit, Albpetrol sh.a do të duhet të ketë një mekanizëm efektiv për të monitoruar dhe vlerësuar përmbushjen e tyre. Kjo përfshin krijimin e një procesi të përshtatshëm për të kontrolluar përdorimin e politikave dhe procedurave, si dhe për të përditësuar ato

në varësi të ndryshimeve të rrethanave të brendshme dhe të jashtme që mund të ndikojnë në sigurinë e informacionit.

Duke ndjekur këto hapa dhe duke pasur një qasje të kujdesshme dhe të përkushtuar në hartimin dhe implementimin e politikave dhe procedurave të reja të sigurisë së informacionit, Albpetrol sh.a, do të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e standardeve të ISO 27001:2022 dhe të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë për të dhënat dhe informacionin e saj.

2. Aplikimi, Vlerësimi, Rezultati dhe Marrja e Certifikimit


Pas përfundimit të fazës së ndërtimit dhe implementimit të kërkesave të azhuruara të standardeve ISO 27001:2022, Albpetrol sh.a do të aplikojë për kryerjen e certifikimit. Kjo fazë kërkon që organizata të përmbushë kushtet dhe procedurat e Trupës Çertifikuese për certifikimin e sigurisë së informacionit.

Aplikimi për certifikim do të përfshijë një proces vlerësimi të hollësishëm të implementimit të standardeve, duke siguruar që të gjitha kushtet dhe udhëzimet janë ndjekur me saktësi. Albpetrol sh.a do të fitojë një certifikatë e cila do të konfirmojë përmbushjen e kërkesave të standardeve të sigurisë së informacionit.

Në përfundim, implementimi dhe certifikimi i standardeve të sigurisë së informacionit janë procese komplekse dhe të rëndësishme për organizatën. Për të siguruar një proces të suksesshëm është e rëndësishme të kemi një angazhim të fortë të konsulencës së specializuar, si dhe një përkushtim të vazhdueshëm për të mbajtur standarde të larta të sigurisë në të gjitha nivelet e operacioneve.

6. Aktiviteti dhe kohëzgjatja

Ky aktivitet do të përfundojë 3 muaj pas fillimit të tij sipas tabelave me poshtë paraqitur.



NR	Aktiviteti	Kohëzgjatja
1	Formimi i Grupit përgjegjës dhe përgatitja për implementimin e ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019).	3-5 ditë
2	Vlerësimi i situatës aktuale të menaxhimit të brendshëm.	5-7 ditë
3	Hartimi i dokumentacionit përkatës përshtatja me aktivitetin.	20-25 ditë
4	Trajnimi i stafit, fillimi dhe zbatimi i Sistemit ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019)	5-10 ditë
5	Implementim i sistemit të menaxhimit sipas standardit ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019)	10-15 ditë
6	Rishikimi, Analizim, Ndërhyrje dhe Rregullime të Sistemit sipas ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019)	5-7 ditë
7	Përzgjedhja Trupës Certifikuese të Akredituar për këtë standard	3-5 ditë
8	Kryerja e Auditimit nga kjo palë e trete (Auditimit Certifikues)	5-10 ditë
9	Marrja e Certifikatës ISO 27001	5-6 ditë

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen: Certifikimi i sigurisë ISO 27001:2022 dhe implementimi i tij në Albpetrol sh.a

Afatet e ekzekutimit: Certifikimi i sigurisë ISO 27001:2022 dhe implementimi i tij në Albpetrol sh.a do të kryhet me afat 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, sipas kërkesave të AK, në përputhje me specifikimet teknike dhe termat e references.

NR	Aktiviteti	Kohëzgjatja
1	Formimi i Grupit përgjegjës dhe përgatitja për implementimin e ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019).	3-5 ditë
2	Vlerësimi i situatës aktuale të menaxhimit të brendshëm.	5-7 ditë
3	Hartimi i dokumentacionit përkatës përshtatja me aktivitetin.	20-25 ditë
4	Trajnimi i stafit, fillimi dhe zbatimi i Sistemit ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019)	5-10 ditë
5	Implementim i sistemit të menaxhimit sipas standardit ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019)	10-15 ditë
6	Rishikimi, Analizim, Ndërhyrje dhe Rregullime te Sistemit sipas ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019)	5-7 ditë
7	Përzgjedhja Trupës Certifikuese te Akredituar për këtë standard	3-5 ditë
8	Kryerja e Auditimit nga kjo palë e trete (Auditimit Certifikues)	5-10 ditë
9	Marrja e Certifikatës ISO 27001	5-6 ditë

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

4. QËLLIMI I PROJEKTIT

ISO 27001 është standardi i vetëm që përcakton specifikimet për një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS).

Gjithnjë e më shumë institucione dhe kompani po arrijnë certifikimin ISO 27001 për të nënvizuar qëndrueshmërinë e menaxhimit të tyre të sigurisë së informacionit. Organizatat të cilat janë të certifikuara me ISO 27001 kanë një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit që siguron konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave dhe informacionit që ata trajtojnë. Politikat, proceset dhe procedurat që përbëjnë këtë sistem menaxhimi shqyrtohen dhe testohen çdo vit nga auditorë të pavarur të palëve të treta, të cilët kanë fuqinë të tërheqin certifikimin nëse gjërat nuk janë në rregull.

Organizatat gjithnjë e më shumë duhet të tregojnë se mund të besohen për sigurinë e informacionit dhe menaxhimin e privatësisë dhe të kesh ISO 27001 tregon se një organizatë ka identifikuar rreziqe dhe ka vendosur masa parandaluese për të mbrojtur organizatën nga shkeljet e sigurisë së informacionit

5. OBJEKTI I PROJEKTIT

Zbatimi i një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit do të sigurojë Albpetrol sh.a një sistem që do të ndihmojë në eliminimin ose minimizimin e rrezikut të një shkelje të sigurisë që mund të ketë implikime ligjore ose të vazhdueshmërisë së biznesit.

Një sistem efektiv i menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001 (ISMS) siguron një kuadër menaxhimi të politikave dhe procedurave që do të mbajnë informacioni të sigurt, pavarësisht nga formati. Pas një sërë rastesh të profilit të lartë, është vërtetuar se është shumë e dëmshme për një organizatë nëse informacioni bie në duar të gabuara ose në domain publik. Duke krijuar dhe mbajtur një sistem të dokumentuar të kontrolleve dhe menaxhimit, rreziqet mund të identifikohen dhe zvogëlohen.

Implementimi i ISO 27001 tregon se Albpetrol ka:

- Informacion të mbrojtur nga marrja e personave të pa autorizuar;
- Informacioni i siguruar është i saktë dhe mund të modifikohet vetëm nga përdoruesit e autorizuar;
- Vlerësuar rreziqet dhe zbutur ndikimin e një shkelje;
- Është vlerësuar në mënyrë të pavarur sipas një standardi ndërkombëtar bazuar në praktikën më të mirë të industrisë.

Albpetrol sh.a operon në Patos, Ballsh – Cakran – Molja, Vllahinë – Kocul dhe Kucove si dhe një Seli Qendrore në Rr. “Fier – Patos”, km.7.

Të gjitha këto vende të ushtrimit të aktivitetit të Albpetrol sh.a, do të jenë objekt auditimi dhe vizite gjatë procesit të certifikimit. Siguria korrekte e aktiviteteve institucionale lidhur me proceset korporative nga Albpetrol sh.a janë të lidhura me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave në sistemet informatike.

Në këtë kontekst, duke marrë parasysh atë që është parashikuar nga Planet Vjetore për Informatikën në Administratën Publike dhe AKCESK (AKSK), Albpetrol sh.a ka vendosur të përcaktojë dhe te zbatojë një Sistem Efikas të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (në vijim "ISMS"), sipas versionit EN ISO 27001:2022.

6. SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR CERTIFIKIMI I SIGURISE ISO 27001:2022 DHE IMPLEMENTIMI I TIJ NE ALBPETROL SH.A

6. Infrastruktura IT

Infrastruktura siguron rrugën e komunikimit dhe shërbimet ndërmjet përdoruesve, proceseve, aplikacioneve, shërbimeve, rrjeteve të brendshme dhe të jashtme / internetit. Albpetrol sh.a ka rreth 260 kompjutera dhe përdorues të lidhur në rrjet, përfshirë Administratën Qëndrore, 3 Qendra Prodhimi të Naftës dhe 7 Qendra Shërbimi. Sistemi operativ i instaluar në PC janë Ëindoës.

Dhoma e serverit është qendra kryesore e rrjetit tonë dhe është një vend në të cilin janë vendosur të gjitha serverat dhe sistemet operacionale (Fireëall, Sëitch aksesi dhe SAN, Servera backup, etj.) Të gjithë serverët do të ndajnë një Hapesire të Ruajtjes së të dhënave(SAN) që përbëhet nga storage.

Për rritjen e burimeve të infrastrukturës përdoret teknologjia e virtualizimit e cila konsiston në përmirësimin e serverëve, shfrytëzimin dhe konsolidimin, alokimin dinamik të burimeve dhe menaxhimin, izolimin e ngarkesës së punës, sigurinë dhe automatizimin. Virtualizimi bazohet në hypervisor VMËARE dhe HYPER-V. Hosts janë konfiguruar në grup me disponueshmëri të lartë e cila përdoret për të përmirësuar besueshmërinë, duke ulur kohëzgjatjen në mjedise virtuale dhe për të përmirësuar rikuperimin në rastin e fatkeqësive natyrore.

Sistemi operativ që përdoret për platformat e serverit janë Ëindoës Server, Linux, vMëare dhe Centos.

Infrastruktura ka këto shërbime:

- Redundant Domain Controller;
- Arkiva digjitale;
- Azure AD;
- Forcepoint;
- Sistemi i menaxhimit të alarmeve në dhomën e serverave;
- Akses kontrolli për dhomën e serverave;
- Sistemi GPS;
- Sistemi ERP;
- Ëireless Controller, VPN, Clearpass;
- XVR, NVR;
- Etj.

Sisteme të cilat janë në Cloud:

- Office 365 dhe email adresat;
- Ëebsite ëëë.albpetrol.al

Infrastruktura ka dy linja mbështetëse të ofruesve të internetit. Linja primare ofrohet me fibër optike dhe linja dytësore ofrohet me Radio Link.

Infrastruktura ofron shërbime interneti të dedikuar për:

- Përdoruesit e Administratës Qëndrore;
- Përdoruesit e Qëndrave të Shërbimit dhe Prodhimit;
- Platforma e Operimit të Sistemit;

-
- Rrjetin Ëireless;
 - Etj.
- Janë disa rregulla të përcaktuara se cilat lloje të trafikut të rrjetit do të lejohen përmes fireëall dhe çfarë do të bllokohet nga shërbime të ndryshme.

Infrastruktura e rrjetit dhe komunikimi ndërmjet qëndrave realizohet nga linjat VPN.

Aplikacioni për filtrim në internet parandalon aksesin në materiale të dëmshme ose të papërshtatshme, gjithashtu monitorimi na ndihmon për të identifikuar aktivitetin online në internet për të gjithë përdoruesit.

7. Nisur nga rëndësia e sistemeve të teknologjise së sistemeve IT/OT nevojitet Përgatitja për Certifikim ISO 27001 për sigurinë e informacionit në Albpetrol sh.a , sipas versionit të standardit ISO 27001:2022.
8. Adoptimi dhe zhvillimi i një sistemi menaxhimi sipas standardeve ISO, është një vendim strategjik që i mundëson Albpetrol sh.a përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së përgjithshme.
9. **Standardi ISO që duhet implementuar në Albpetrol sh.a.**
Duke u bazuar edhe tek kërkesat e institucioneve si AKCESK (AKSK) por edhe praktikat më të mira Ndërkombëtare, në Albpetrol sh.a kërkohet:
 - ISO 27001:2022 – Sistemi Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit

10. Kërkesat e Implementimit dhe Certifikimit të Albpetrol sha.

Dy janë fazat nëpër të cilat duhet të kalojë ky proces:

1. Konsulenca, Hartimi, Implementimi dhe Trajnimi

Fillimisht, procesi duhet të udhëhiqet dhe të implementohet nga një kompani e specializuar në konsulencë për ndërtimin, përshtatjen, realizimin, implementimin dhe trajnimin e stafit për të përmbushur kërkesat e azhuruara të standardeve ISO/IEC 27001:2022. Kjo kërkesë për një studio të specializuar në konsulencë është kritike, pasi kërkon një konsulencë të integruar që përmban ekspertizën teknike mbi normat dhe azhurnimet e tyre, si dhe mbi aktivitetin specifik që ofron Albpetrol sh.a.

Gjithashtu, është e rëndësishme që studioja e konsulencave të ketë njohuri të thella në lidhje me udhëzimet e standardeve për sigurinë e informacionit, siç janë ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019. Përmes trajnimeve dhe implementimeve të kujdesshme, personeli i Albpetrol sh.a do të pajiset me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të menaxhuar sigurinë e informacionit në përputhje me kërkesat e këtyre standardeve të rëndësishme.

Për hartimin e politikave dhe procedurave sipas standardit ISO 27001:2022, Albpetrol sh.a do të duhet të ndjekë një proces të strukturuar dhe të kujdesshëm që i përmbush kërkesat e këtij standardi të rëndësishëm për sigurinë e informacionit. Kjo përfshin një sërë hapash që organizata duhet të ndërmarë për të përshtatur politikat dhe procedurat e saj ekzistuese ose për të hartuar të reja që përputhen me kriteret e ISO 27001:2022. Këto hapa përfshijnë:

- Identifikimi i Politikave Ekzistuese dhe Mungesave: Fillimisht, Albpetrol sh.a do të duhet të identifikojë politikat dhe procedurat ekzistuese për sigurinë e informacionit në organizatë. Ky proces

do të përfshijë një analizë të hollësishme për të vlerësuar se ku ndodhen politikat aktuale, cilat janë përmirësimet e nevojshme dhe cilat mungojnë në përputhje me standardet e ISO 27001:2022.

- Hartimi i Politikave të Reja: Bazuar në identifikimin e mungesave dhe nevojat e organizatës për të përmbushur kërkesat e ISO 27001:2022, Albpetrol sh.a do të hartojë politika të reja për sigurinë e informacionit. Këto politika do të përfshijnë një gamë të gjerë të çështjeve si menaxhimi i rrezikut, qasja në informacion, siguria fizike dhe logjistika, siguria e rrjetit, dhe të drejtat e përdoruesve. Politikat e reja duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të përshtatshme për nevojat specifike të organizatës.
- Hartimi i Procedurave Të reja: Për të përkrahur politikat e reja të sigurisë së informacionit, Albpetrol sh.a do të duhet të hartojë procedura të detajuara që t'i përmbushin kërkesat specifike të këtyre politikave. Këto procedura do të përshkruajnë hapat e nevojshëm për të zbatuar politikat në praktikë, duke përfshirë proceset për identifikimin e rreziqeve, vlerësimin e tyre, dhe marrjen e masave për zbutjen e tyre.
- Kontrolli dhe Mirëmbajtja e Politikave dhe Procedurave: Pas hartimit dhe zbatimit të politikave dhe procedurave të reja të sigurisë së informacionit, Albpetrol sh.a do të duhet të ketë një mekanizëm efektiv për të monitoruar dhe vlerësuar përmbushjen e tyre. Kjo përfshin krijimin e një procesi të përshtatshëm për të kontrolluar përdorimin e politikave dhe procedurave, si dhe për të përditësuar ato në varësi të ndryshimeve të rrethanave të brendshme dhe të jashtme që mund të ndikojnë në sigurinë e informacionit.
Duke ndjekur këto hapa dhe duke pasur një qasje të kujdesshme dhe të përkushtuar në hartimin dhe implementimin e politikave dhe procedurave të reja të sigurisë së informacionit, Albpetrol sh.a, do të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e standardeve të ISO 27001:2022 dhe të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë për të dhënat dhe informacionin e saj.

1. Aplikimi, Vlerësimi, Rezultati dhe Marrja e Certifikimit


Pas përfundimit të fazës së ndërtimit dhe implementimit të kërkesave të azhuruara të standardeve ISO 27001:2022, Albpetrol sh.a do të aplikojë për kryerjen e certifikimit. Kjo fazë kërkon që organizata të përmbushë kushtet dhe procedurat e Trupës Çertifikuese për certifikimin e sigurisë së informacionit.

Aplikimi për certifikim do të përfshijë një proces vlerësimi të hollësishëm të implementimit të standardeve, duke siguruar që të gjitha kushtet dhe udhëzimet janë ndjekur me saktësi. Albpetrol sh.a do të fitojë një certifikatë e cila do të konfirmojë përmbushjen e kërkesave të standardeve të sigurisë së informacionit.

Në përfundim, implementimi dhe certifikimi i standardeve të sigurisë së informacionit janë procese komplekse dhe të rëndësishme për organizatën. Për të siguruar një proces të suksesshëm është e rëndësishme të kemi një angazhim të fortë të konsulencës së specializuar, si dhe një përkushtim të vazhdueshëm për të mbajtur standarde të larta të sigurisë në të gjitha nivelet e operacioneve.

7. Aktiviteti dhe kohëzgjatja

Ky aktivitet do të përfundojë 3 muaj pas fillimit të tij sipas tabelave me poshtë paraqitur.



NR	Aktiviteti	Kohëzgjatja
1	Formimi i Grupit përgjegjës dhe përgatitja për implementimin e ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019).	3-5 ditë
2	Vlerësimi i situatës aktuale të menaxhimit të brendshëm.	5-7 ditë
3	Hartimi i dokumentacionit përkatës përshtatja me aktivitetin.	20-25 ditë
4	Trajnimi i stafit, fillimi dhe zbatimi i Sistemit ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019)	5-10 ditë
5	Implementim i sistemit të menaxhimit sipas standardit ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019)	10-15 ditë
6	Rishikimi, Analizim, Ndërhyrje dhe Rregullime te Sistemit sipas ISO/IEC 27001:2022 (me zgjerim në udhëzimet ISO/IEC 27017:2015 dhe ISO/IEC 27018:2019)	5-7 ditë
7	Përzgjedhja Trupës Certifikuese te Akredituar për këtë standard	3-5 ditë
8	Kryerja e Auditimit nga kjo palë e trete (Auditimit Certifikues)	5-10 ditë
9	Marrja e Certifikatës ISO 27001	5-6 ditë

Shënime:

- Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- Kudo në Specifikimet Teknike ku janë cituar standarde ndërkombëtare, do të pranohen edhe cilësime ekuivalente nga një institut vendor.
- Gjuha e Dokumentacionit: Shqip

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriteve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit limit

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi për përvojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

2.3.2. Certifikatë ISO 9001:2015 ose e perditesuar (për sistemet e menaxhimit të cilësive), e vlefshme, e operatorit ekonomik, ose ekuivalente, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ISO 27001:2022 ose e përditësuar, ose ekuivalente me të për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

2.3.4. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, duhet të ketë staf teknik minimalisht 6 (gjashtë) punonjës.

Për këtë të paraqitet:

- Vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për të paktën tre muajt e fundit.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

